

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërhyrje në zona sportive dhe lodra për fëmijë “Dua të luaj” Faza II” .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Fondi limit: 590,887,400.14 _Monedha, pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/a e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkoet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet

tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.“

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nën 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nën 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën

e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e larte monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” e cila përfshin kategoritë e mëposhtme.

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

- NP-1 A: Punime gërmimi në tokë
- NP-2 B: Ndërtime civile dhe industriale
- NP-4 E: Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP-5 A: Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
- NP-7 A: Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.
- NP-11 A: Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TM dhe shpërndarjen e energjisë
- NP-12 A: Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

- NS-1 A: Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS-2 A: Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre
- NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese
- NS-6 A: Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
- NS-8 C: Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- NS-12 A: Impiant teknologjik, termike dhe te kondicionimit
- NS-18 A: Punime Topogjeodezike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

ARGUMENTIMI LICENCAT

| Kategoria e kërkuar | Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|----------------------------|---|--|--|---|
| NP-1 A | Punime gërmimi në tokë | <ul style="list-style-type: none">- Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³, me shk në mjet- Mbushje me material të gërmuar me parë (sistemime)<ul style="list-style-type: none">- Gërmim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m³, shkarkimi në auto- Gërmim dhe transport dhe për kanalet e tubove dhe pusetave | 0-20 mln leke | 8'059'512.54 lekë |

| | | | | |
|---------|---|--|------------------|---------------------|
| NP-2 B: | Ndërtime civile dhe industriale | <ul style="list-style-type: none"> - Plint b/a C25/30 - Mur b/a C25/30 - Trare solete C25/30 - Solete te plota C25/30 - Trare themeli b/a C25/30 - Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m - F V hekur betoni periodik 0 6- 10 mm - F V hekur betoni periodik 0 > 10 mm - Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 3m me lla<£ perzier M25 - Ndertim muri gipsi t= 10 cm me dy shtresa - Shtrese betoni C 7/10 7 cm - Nenshtrese zhavorri nen themele t=30 cm (per themelet) - Shtrese betoni i varfer C 12/15 nen themele t=10 cm (shtrese e varfer betoni per themelin) - Plint b/a C25/30 - Kollona b/a C25/30 - Trare themeli b/a C25/30 - F.V te struktures metalike perfshire prixoniere, flashings dhe bulona per fiksimin e struktures | 21-50 mln leke | 32'664'097.88 lekë |
| NP-4 E: | Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese çakelli t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri - Shtrese stabilizanti t =10 cm - Shtrese rere (silici) - Shtrese avullizoluese gjeotekstil per fusha te futbollit - Struktura te holla monolite betoni C 16/20 (per fiksim bordure- bordura betoni 20x35 cm) - F.V. Rrjete e elektrosalduar per shtrime Ø4 mm cdo 10cm per betonin - F.V. Shtresat e fushes se futbollit: Tapet Sintetik + Plastike Kokrrizore (8 kg /m2) per fusha te futbollit + vijëzim - Shtrese cakelli t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese stabilizanti t = 10 cm - Shtrese rere nen pllaka, t=6 cm | 201-400 mln leke | 370,334,586.44 lekë |

| | | | | |
|---------|--|---|---------------|-------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> - Trotuar me pllaka veteshtrenguese betoni, t=6cm - Shtrese cakelli nen bordure, t=10 cm (poshte bordurave -bordura betoni 20x35 cm) - Shtrese llac cemento 2cm (poshte bordurave -bordura betoni 20x35 cm) - Struktura te holla monolite betoni C 16/20 (per fiksim bordure- bordura betoni 20x35 cm) - F.V bordura betoni 20x35 cm - F.V bordura betoni 20x30 cm - Shtrese cakelli nen bordure, t=10 cm (poshte bordurave- bordura betoni te pemeve 60x20 cm) - Shtrese llaç cemento 2cm (poshte bordurave- bordura betoni te pemeve 60x20 cm) - Struktura monolite betoni C 16/20 (per fiksim bordure - bordura betoni te pemeve 60x20 cm) - F.V bordura betoni 60x20 cm (bordura te pemeve) | | |
| NP-5 A: | Punime nëntokësore, ura e vepra arti. | <ul style="list-style-type: none"> - Rezervuari nën toke - Pllake themeli b/a C 20/25 - Mure b/a t=21-30 cm per rezervuar kenddrejte C 25/30 - Solete te plota C25/30 - F V hekur betoni periodik 0 6- 10 mm - F V hekur betoni periodik 0 > 10 mm | 0-20 mln leke | 1'168'904.63 lekë |
| NP-7 A: | Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje | <ul style="list-style-type: none"> - F.V Tub HDPE Ø63x5.8 mm, PN16 - F.V Tub HDPE Ø50x4.6 mm, PN16 - F.V Tub HDPE Ø63x5.8 mm, PN16 - F.V Tub HDPE Ø32x3.0 mm, PN16 - F.V Tub HDPE Ø25x2.5 mm, PN16 - F.V Tub HDPE Ø20x2.0 mm, PN16 - F.V. Rakorderi (8% i vleres totale te tubave) - F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm - F.V Puseta betoni (40 x 40) cm, me kapak b/a 40x40 mm me trashesi te mureve 15 cm beton M-250 perfshi hekur 90 kg/m3 betoni, lysterjen me dy duar primer. - F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t = 3.0 mm, PN 20 - F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, PN 16 | 0-20 mln leke | 2,264,814.61 leke |

| | | | | |
|----------|---|---|---------------|--------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> - F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, PN 16 - F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, PN 16 - F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, PN 16 - F.V Rakorderi per montim tubash (brryla, tee, reduksion, etj)(8% i vleres totale te tubave) - F.V Rakorderi per mberthim tubosh (8% i vleres totale te tubave) - F.V Tubo shkarkimi PP d125 - F.V Tubo shkarkimi PP d110 - F.V Tubo shkarkimi PP d50 - F.V Pilete dysHEMEJE d50 - F.V Pilete Lineare d50 - F.V Tapa pastrimi Ø110 mm - F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)(8% i vleres totale te tubave) - F.V Shtrese rere - F.V Puseta betoni (60 x 60) cm, me kapak gize 0 60 mm me trashesi te mureve 15 cm beton M-250 perfshi hekur 90 kg/m3 betoni, lyerjen me dy duar primer dhe kapak gize per ngarkese 40 Ton Klasa D 400, - Nenshtrese betoni C 12/15 per pusetat - F.V Tub HDPE i brinjezuar SN8 Ø200 mm - F.V Tubo shkarkimi PP d110 - F.V Tub i brinjezuar HDPE SN8 Ø200 mm - F.V Tub i brinjezuar HDPE SN8 Ø250 mm - F.V Tub HDPE i brinjezuar SN8 Ø315 mm - F.V Elemente ndihmese + rakorderi (reduksion, brage, bryla etj.)(8% i vleres totale te tubave) - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm | | |
| NP-11 A: | Ndërtim për N/Stacionet, kabinet e transformatorëve, linja e TM dhe | <ul style="list-style-type: none"> - F.V Ndricules LED rrugor 150w - F V shtylle metalike ndricimi H=4.5m - F V ndricues brenda ne park per shtylle H=4.5m - FV Ndricules Spot, LED 22W, jashte murit | 0-20 mln leke | 12,542,640.31 lekë |

| | | | | |
|----------|------------------------------------|---|---------------|-------------------|
| | shpërndarjen e energjisë | <ul style="list-style-type: none"> - FV shtylla metalike konike ndricimi H=9m PAICC-3 - FV Krahe ndricuesi tek 1500x1500 - F.V Ndricues projektor me llampe SAP- T 250w - FV Ndricues LED i Inkasuar ne Toke TVDM-L301 RGB 9W - F V Minikuader shtylle me morseteri 4P, siguresse 10A + kapak - FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm - Puset kontrolli me kapak gize te rende(60x60x60cm) - F.V Tuba ujesjellesi ADPE Pn 10 f=110mm - Germim dheu gropa shtyllash - Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5km - F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement (me rele muzgu per ndricim zonash te vecanta, ura, etj.) - F.V Percjelles tokezimi bakri , Cu, S=35mm2 i zhveshur - FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm - F.V Qeles 1 polar 220V 10A | | |
| NP-12 A: | Punime të inxhinierisë së mjedisit | <ul style="list-style-type: none"> - Transport dheu me auto deri ne 5 km - Mbushje me dhë vegjetal dhe humus + fere bari h=30-40 cm ne zonat me gjelberim (pemet ne trotuarin perimetral dhe gjelberimi ne brendesi te parkut) - F.V. LAGERSTROEMIA h=3.5m - peme - F.V TILIA CORDATA h=3.6m - peme - F.V. MAGNOLIA GRANDIFLORA h=3m - peme - F.V OLEA EUROPAEA h=3m - peme - F.V CAMELLIA h=1.5 - shkurre | 0-20 mln leke | 9'678'695.39 lekë |
| NS-1 A: | Punime për prishjen e ndërtimeve | <ul style="list-style-type: none"> - Prishje mur tulle pa pastrim - Prishje mur tulle me pastrim - Prishje mur tulle me pastrim - Prishje shtresa betoni - Prishje soleta b/a - Prishje mure betoni - Prishje mure beton/arme - Prishje kollona, trare b/a - Prishje struktura prej guri - Prishje struktura prej betoni | 0-20 mln leke | 2'894'538.63 lekë |

| | | | | |
|---------|---|---|---------------|-------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> - Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri - Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri - Heqje cmontim i kangjellave metalike te murit rrethues ekzistuese | | |
| NS-2 A: | <p>Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre</p> | <ul style="list-style-type: none"> - F.V Tub multistrat PEX-AL-PEX, Ø16x2x0.25 - F.V Tub multistrat PEX-AL-PEX, Ø20x2x0.25 - F.V Elemente mberthyes e fiksues (Upa metalik, Prixonier, Luktide, fasheta, shirit, goxhd, shkum)(5% i vleres totale te tubave) - F.V. Saracineska bronzi 3/4" - F.V. Saracineska bronzi 1" - F.V Kolektor shpendares 3/4" (4+4) - F.V Kolektor shpendares 3/4" (5+5) - F.V WC allafrenga importi - F.V lavaman porcelani importi me mishelator - F.V Pajisje hidrosanitare Dush porcelani importi me mishelator - F V bolier 80 liter, uje te ngrohte - F.V. Mini saracineska M/M 1/2 - 1/2 - F.V Tub Zingato Ø2 " + Rakorderi - F.V Tub Zingato Ø1 1/4" + Rakorderi - F.V Tub Celik Ø2 " + Rakorderi - F.V. Elemente mberthyes e fiksues (5% i vleres totale te tubave) - F.V. Elektrovalvol nderprerese DN 50 (Ø2") - F.V. Valvol nderprerese DN 50 (Ø2") - F.V. Valvol nderprerese DN 32 (Ø 1 1/4") - F.V. Valvol moskthimi DN 50 (Ø2") PN16 - F.V. Filter DN 50, Ø2 " - F.V. Reduktor presioni Ø2" - F.V. Xhunto antivibruese DN50 (Ø2") - F.V. Mates uji 2 " - F.V. Galexhant mekanik 1 1/2" - F.V. Galexhant elektrik - F.V. Elemente plotsues per instalimet e linjave hidraulike (Niple, Manikota, Hollandez, Fije lini, Paste, Loctide leng, | 0-20 mln leke | 3'179'565.94 lekë |

| | | | | |
|---------|--|---|------------------|--------------------|
| NS-4 A | Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese | <ul style="list-style-type: none"> - Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cimento. Pergatitur nga dy komponente A+B (Hidroizolim ne nyje sanitare) - Shtrese me pllaka gres ne tualete ngjtur me kolle - Shtrese me pllaka porcelanat importi - ambiente te brendshme - Plintuse grez importi, h = 10 cm - Patinim muri me stuko - Suva brenda mur tulle h~4m me krah, lla<^ perzier M 25 - Suva e zakonshme fasade mur tulle mbi 8 m - Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60 cm - F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham - Dyer te brendshme druri importi cilesia e pare - Lyerje me boje hidroplastike - Veshje me pllake majolike (nyje sanitare) | 0-20 mln leke | 7'714'194.56 lekë |
| NS-6 A: | Sinjalistika rrugore ndriçuese jo | <ul style="list-style-type: none"> - Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (paste) - Parapet i njeanshem per beton (ø 60) + aksesoret - Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (sprajt) - F.V kon sigurie vertikale PVC Portokalli/ Floureshent h= 75 cm, te korsia e bicikletave - F.V Bllokuese trafiku prej betoni dekorativ | 0-20 mln leke | 7'418'596.63 lekë |
| NS-8 C: | Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri | <ul style="list-style-type: none"> - F.V Porta per fusha futbollli 5.0x2.0 m (perfshire aksesoret) - Struktura monolite betoni, C 20/25 (themel betoni per te mbajtur konstruksionin metalik) - F V hekur betoni Ø 6-10 mm (hekuri per themel betoni per te mbajtur konstruksionin metalik) | 101-200 mln leke | 71,623,632.79 leke |

| | | | | |
|--|--|---|--|--|
| | | <ul style="list-style-type: none"> - Rrethimi i fushes (kostruksione metalike te perbera)(perfshire aksesoret dhe elementet e mberthimit) - Rrjeta metalike e galvanizuar tek Rrethimi metalik (F.V Rrjete teli 8x8/1,4mm) - F.V Tabele kosha Fushe Basketball (perfshire aksesoret) - F.V Rrjete per Fushe Tenisi (perfshire mbshteteset metalike dhe aksesoret) - Struktura monolite betoni, C 20/25 (themel betoni per te mbajtur kostruksionin metalik) - F V hekur betoni Ø6-10 mm (hekuri per themel betoni per te mbajtur kostruksionin metalik) - Rrethimi I fushes (kostruksione metalike te perbera)(perfshire aksesoret dhe elementet e mberthimit) - Rrjeta metalike e galvanizuar tek Rrethimi metalik (F.V Rrjete teli 8x8/1,4mm) - Nenshtrese zhavorri nen themele t=30 cm (per themelin) - Shtrese betoni i varfer C 12/15 nen themele t=10 cm (shtrese e varfer betoni per themelin) - Plint b/a C 25/30 (themel betoni per te mbajtur kostruksionin metalik) - Mbushje me material te germuar me pare - F V hekur betoni, 0 > 12mm (hekuri per themel betoni per te mbajtur kostruksionin metalik) - Kostruksione metalike te perbera (Aksesoret dhe elementet e mberthimit - Tub +profila metalik te rrethimit) | | |
|--|--|---|--|--|

| | | | | |
|----------|---|--|---------------|-----------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> - Boje vaji ne siperfaqe metalike - Rrjeta metalike e galvanizuar tek Rrethimi metalik (F.V Rrjete teli 8x8/1,4mm) - F.V Stola gjatesor me konstruksion metalik dhe me veshje druri - F.V Stola gjatesor me konstruksion betoni dekorativ - Veshje fasade me alukobonde - F V konstruksione metalike te perbera (F.V te struktures metalike perfshire prixhoniere, flashings dhe bulona per fiksimin e struktures) - FV Struktura druri speciale me material drusor te imprenjuara me vakum per perdorim ne ambjente te jashtme me prezence uji dhe me lageshtire - FV Struktura betoni me material betoni dekorativ - F.V Stol me konstruksion metalik 1.8x0.5x0.5 m + Shtrim me dru ne pjesen ulese me themel betoni - F.V Stol betoni dekorativ 1.8x0.5x0.5 m - F.V kufizuese pemesh me konstruksion metalik + dru - F.V. Kosha per mbeturina te vogla 30 lt | | |
| NS-12 A: | Impiant teknologjik, termike dhe te kondicionimit | <ul style="list-style-type: none"> - F.V Tuba bakri Ø 6.35, s= 0.8 mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor 5= 10~13mm - F.V Tuba bakri Ø 12.7, s= 0.8 mm, per R410A, dhe termoizolim me spesor 5= 10~13mm - - F.V Tubo PP-R Ø32 - F.V Tubo PP-R Ø25 - F.V Rakorderi (8% i vleres totale te tubave) | 0-20 mln leke | 129,034.54 lekë |

| | | | | |
|----------|-----------------------|---|---------------|---------------|
| | | F.V Elemente mberthyes e fiksues | | |
| NS-18 A: | Punime Topogjeodezike | Për rievime, piketime ne përputhje me projektin | 0-20 mln leke | 0-20 mln lekë |

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi
- 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinier Elektrik
- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) inxhinjer Mjedisi
- 2 (dy) Inxhinier Mekanik

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specififikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

ARGUMENTIMI STAFI DREJTUES

| | |
|-------------------------|---|
| 2 Inxhinier Ndërtimi | Inxhinieri i ndërtimit nevojitet per organizimin e kantierit te ndërtimit, për ndjekjen në tërësi të punimeve dhe bën koordinim e të gjithë personelit teknik në objekt për mbarëvajtjen e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe grafikut të parashikuar në kontratë. (Referuar zërave të punimeve të preventivit) |
| 2 Inxhinier Hidroteknik | Inxhinieri hidroteknik nevojitet për ndjekjen e punimeve të kullimit të ujërave, punimet hidrosanitare të ndërtesës; (Referuar zërave të punimeve të preventivit). |

| | |
|----------------------|--|
| 2 Inxhinier Mekanik | Inxhinieri mekanik nevojitet për ndjekjen e punimeve të kondicionimit, të mbrojtjes nga zjarri dhe punimeve hidromekanike (Referuar zërave të punimeve të preventivit). |
| 2 Inxhinier Elektrik | Inxhinieri elektrik nevojitet për ndjekjen e punimeve elektrike dhe të ndriçimit hidromekanike (Referuar zërave të punimeve të preventivit). |
| 2 Inxhinier Gjeodet | Inxhinieri gjeodet nevojitet për piketimin fillestar të objektit dhe piketimin në vazhdimësi të të gjithë punimeve sipas proceseve të punës. (Referuar zërave të punimeve të preventivit). |
| 1 Inxhinier Mjedisi | Inxhinieri i mjedisit nevojitet për ndjekjen e punimeve të gjurmimit me qëllim ruajtjen e gjelbërimit, ruajtjen e ambientit gjate kryerjes se punimeve; përcaktimin/selektimin e pikës se depozitimit se hedhurinave dhe materialeve te dala nga gjurmimi. (Referuar zërave te punimeve te preventivit). |

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" rekomandohet të jete ne kantier per minimizin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **95** persona për periudhën, tremujore nga data e zhvillimit te procedures e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre mujor e nga data e zhvillimit të tenderit,
- Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Numri i punonjësve është përcaktuar ne baze te grafikut te detajuar per zbatimin e punimeve sipas proceseve te punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku per nje periudhe te caktuar te zbatimit te punimeve numri i punonjësve (Specialiste + punetore krahu, manovratore, kamioniste, etj.) duhet te jete minimalisht **95**. Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit te tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 95 persona, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike jane bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport) zëri fuqi punëtore zë rreth 20% të kostos.

Total orë pune (Specialist + Punëtor + Manovrator + Kamionist)= 397'286 orë (sipas zbërthimit të analizave) Ore/1 ditë pune= 8 ore

Total Ditë pune punëtori= 397'286 orë/8 orë= 49'660 ditë pune

Dite pune gjithsej= 24 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 22 ditë/muaj= 528 ditë pune Numri i fuqisë punëtore = 49'660 dite pu`ne /528 ditë ≈ 95 punëtore

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi/qira/kontrate furnizimi).

| Nr. | Mjeti | Sasia (copë) | Statusi |
|-----|--|--------------|------------------------|
| 1 | Eskavator me zinxhire | 2 | në pronësi ose me qera |
| 2 | Eskavator me goma | 2 | në pronësi ose me qera |
| 3 | Fadrome me goma | 2 | në pronësi ose me qera |
| 4 | Eskavator me zinxhirë i pajisur me çekiç | 1 | në pronësi ose me qera |

| | | | |
|----|---|---|------------------------|
| 5 | Minieskavatore 2 deri 9 ton | 2 | në pronësi ose me qera |
| 6 | Bob Cat | 2 | në pronësi ose me qera |
| 7 | Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton | 5 | në pronësi ose me qera |
| 8 | Kamionçine me kapacitet mbajtës deri 2 ton | 4 | në pronësi ose me qera |
| 9 | Kamion i pajisur me vinç | 2 | në pronësi ose me qera |
| 10 | Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 10 ton | 2 | në pronësi ose me qera |
| 11 | Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton | 2 | në pronësi ose me qera |
| 12 | Grejder | 2 | në pronësi ose me qera |
| 13 | Autobot uji | 2 | në pronësi ose me qera |
| 14 | Betoniere kantieri 500 liter | 2 | në pronësi ose me qera |
| 15 | Asfaltoshtruese | 1 | në pronësi ose me qera |
| 16 | Rrul asfalti Gome-Cilinder 2 – 6 ton | 1 | në pronësi ose me qera |
| 17 | Rrul asfalti Cilindër-Cilindër 4 – 6 ton | 1 | në pronësi ose me qera |
| 18 | Rrul asfalti Gome-Gome mbi 8 ton | 1 | në pronësi ose me qera |
| 19 | Kompresor | 2 | në pronësi ose me qera |
| 20 | Gjenerator | 2 | në pronësi ose me qera |
| 21 | Vibrator betoni | 4 | në pronësi ose me qera |

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Numri i makinerive është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për secilën proces pune është përcaktuar lloji i makinerive dhe ditët e punës

përkatëse Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

ARGUMENTIMI I MJETEVE

| Mjetet | Sasia (copë) | Proceset e punës |
|--|---------------------|--|
| Ekskavator me zinxhir | 2 cope | - Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri - Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri - Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m ³ ,shkarkimi ne auto |
| Ekskavator me goma | 2 cope | - Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , me shk ne mjet |
| Fadrome me Goma | 2 cope | - Prishje struktura prej guri - Prishje struktura prej betoni - Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri - Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri |
| Eskavator me zinxhirë i pajisur me çekiç | 1 cope | - Prishje struktura prej betoni |

| | | |
|--|--------|--|
| Miniekskavatore deri ne 9 Ton | 2 cope | <ul style="list-style-type: none"> - Gërmim dhe transport dheu për kunetat, kanalet e tubove - Germim dhe transport dheu per kanalet e tubove dhe pusetave |
| BobCat | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Mbushje me çakëll gurore (pjesa e mbushjes për sistemimet dhe rregullim kuotash) - Mbushje me material te gërmuar me pare (sistemime) - Kryesisht punime ne rruge të ngushta ku është e pamundur të shkojnë makineritë me të rënda) |
| Kamione vetëshkarkues mbi 20 Ton | 5 cope | <ul style="list-style-type: none"> - Transport dheu me auto deri 5.0 km - Mbushje me çakëll e gur gurore ne trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri. - Mbushje me material te germuar me pare (sistemime) - Shtrese çakelli t=20cm, përhapur e ngjeshur makineri - Shtrese stabilizanti t = 10cm |
| Kamionçine me kapacitet deri ne 2 Ton | 4 copë | <ul style="list-style-type: none"> - F.V Tub HDPE i brinjezuar SN8 Ø200 mm - F.V Tubo shkarkimi PP d110 - F.V Tub i brinjezuar HDPE SN8 Ø200 mm - F.V Tub i brinjezuar HDPE SN8 Ø250 mm - F.V Tub HDPE i brinjezuar SN8 Ø315 mm |
| Kamion i Pajisur me Vinc | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - F.V Tub HDPE i brinjezuar SN8 Ø200 mm - F.V Tubo shkarkimi PP d110 - F.V Tub i brinjezuar HDPE SN8 Ø200 mm - F.V Tub i brinjezuar HDPE SN8 Ø250 mm - F.V Tub HDPE i brinjezuar SN8 Ø315 mm |
| Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 10 ton | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese çakelli t=20cm, përhapur e ngjeshur makineri - Shtrese stabilizanti t =10 cm - Mbushje me cakell gurore (pjesa e mbushjes per sistemimet dhe rregullim kuotash) - Mbushje me material te germuar me pare (sistemime) |
| Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese çakelli t=20cm, përhapur e ngjeshur makineri - Shtrese stabilizanti t =10 cm - Mbushje me cakell gurore (pjesa e mbushjes per sistemimet dhe rregullim kuotash) - Mbushje me material te germuar me pare (sistemime) |
| Greider | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese çakelli t=20cm, përhapur e ngjeshur makineri - Shtrese stabilizanti t =10 cm - Mbushje me cakell gurore (pjesa e mbushjes per sistemimet dhe rregullim kuotash) - Mbushje me material te germuar me pare (sistemime) |
| Autobot Uji | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese çakelli t=20cm, përhapur e ngjeshur makineri - Shtrese stabilizanti t =10 cm - Mbushje me cakell gurore (pjesa e mbushjes per sistemimet dhe rregullim kuotash) - Mbushje me material te germuar me pare (sistemime) |
| Betoniere kantieri 500 liter | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Struktura monolite betoni C 16/20 (per fiksime bordure - bordura betoni te pemeve 60x20 cm) |

| | | |
|--|--------|--|
| Asfaltoshtruese | 1 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi i mbyllur t= 7 cm - Shtrese asfaltobetoni me ngjyra, t=3 cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese binder me granil gur kave t=4 cm, perhapur e ngjeshur me makineri |
| Rrul asfalti Gome-Cilinder 2 – 6 ton | 1 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi i mbyllur t= 7 cm - Shtrese asfaltobetoni me ngjyra, t=3 cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese binder me granil gur kave t=4 cm, perhapur e ngjeshur me makineri |
| Rrul asfalti Cilinder-Cilinder 4 – 6 ton | 1 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi i mbyllur t= 7 cm - Shtrese asfaltobetoni me ngjyra, t=3 cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese binder me granil gur kave t=4 cm, perhapur e ngjeshur me makineri |
| Rrul asfalti Gome-Gome mbi 8 ton | 1 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrese binderi i mbyllur t= 7 cm - Shtrese asfaltobetoni me ngjyra, t=3 cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese binder me granil gur kave t=4 cm, perhapur e ngjeshur me makineri |
| Kompresor | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Shtrim me beton C20/25 te lare t=6cm - Shtrese binderi i mbyllur t= 7 cm - Shtrese asfaltobetoni me ngjyra, t=3 cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese binder me granil gur kave t=4 cm, perhapur e ngjeshur me makineri |
| Gjenerator | 2 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Per sigurimin e energjise elektrike ne raste difekti te sistemit te OSHEE |
| Vibrator thellesie betoni | 4 copë | <ul style="list-style-type: none"> - Plint b/a C25/30 - Mur b/a C25/30 - Trare solete C25/30 - Solete te plota C25/30 - Trare themeli b/a C25/30 - Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m - Pllake themeli b/a C 20/25 - Mure b/a t=21-30 cm per rezervuar kenddrejte C 25/30 - Solete te plota C25/30 |

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik Argumentimi". Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerrat e punimeve janë pjesë e pandare e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | |
|--|-----------------|
| 1. Çmimi | pikët 60 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | pikët 10 |
| 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) | pikët 15 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) | pikët 10 |
| 5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) | pikët 5 |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 60] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

| | |
|---------------|---|
| P_{k1} | Pikët e kriterit që vlerësohet |
| $V_{\min k1}$ | Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet |
| $P_{\max k1}$ | Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet |
| O_{k1} | Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet |

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë

[0 –10 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këto kritere duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizative, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshtë:

- *Punime për ndertimin e terrene sportive (basketboll, futboll, volejboll, padel etj.) me sipërfaqe jo më pak se 2,800 m² për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit* 5 pikë

- *Punime për shtrimin e shesheve me beton të ngjyrosur me sipërfaqe jo më pak se 6,557.5 m² për kontrata të kryera brenda një periudhe një vjeçare, gjatë pesë viteve të fundit*

5 pikë

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 1 vjeçar, afat i cili nënkupton një periudhë 12 muajore të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punimeve dhe volumeve të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike të kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Përmbushja e këtij kriteri do të provohet nepermjet situacioneve perfundimtare sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit Teknik si dhe dorezimit të detyrueshem të informacionit të përmbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1).

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–15 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) [0 - 10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) [0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubrikën specifike/zerin “Siguria në kantiere (Planin I Sigurisë e Kordinimit në Kantiere PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollin) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023”, në preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posaçme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket çështjeve të sigurisë në kantiere, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjisllacionin përkatës.

Siguria në kantiere, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantiere (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të veçantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e veçantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përlllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast jo më pak se **15,890,184.45** leke pa tvsh. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantiere, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantiere”, Aneksi VI “Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantiere të perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantiere/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zerin Siguria në kantiere (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantiere PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollin të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 15,890,184.45 leke pa tvsh.
- Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 15,890,184.45 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)
- Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantiere më të lartë se vlera 15,890,184.45 leke pa tvsh do të vlerësohet si më poshtë:

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

| | |
|---------------|---|
| $V_{\max k5}$ | Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet |
| $P_{\max k5}$ | Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet |
| O_{k5} | Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet |

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendetit, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendetit, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendetit, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shume se dyfishi i** mesatares së ofertave të vlefshme.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendetit impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

$$\begin{aligned}
 O & \quad - \text{(pikët e Ofertës)} \\
 Mo & \quad - \text{Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme} \\
 N & \quad - \text{Numri i ofertave të vlefshme} \\
 PR \text{ (Rrm)} & \quad - \text{Rritje e mundshme} \\
 Mo & \quad = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N \\
 PR & \quad = 200 \% Mo
 \end{aligned}$$

Vlera e ofertave të ofruara $> PR$ rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendetit impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika

38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve janë pjesë e DST.

Ne cdo rast nese janë përmendur marke prodhimi ose proces i vecante ne kete procedure prokurimi me objekt: “ Ndërhyrje në zona sportive dhe lodra për fëmijë “Dua të luaj” Faza II” do te pranohen edhe ekuivalent